REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HAS

KËSHILLI

# Raporti vjetor i transparencës së konsultimeve publike për vitin 2025.

Ky raport paraqet një analizë të detajuar të nivelit të transparencës dhe përfshirjes së publikut në proceset e konsultimit publik të zhvilluara nga Bashkia Has gjatë vitit 2025. Raporti hartohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe synon të rrisë llogaridhënien institucionale, transparencën dhe cilësinë e vendimmarrjes vendore. Proçesi është realizuar në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 "Per vetqeverisjen Vendore", neni 18,

Ligji nr.146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik", dhe Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit". Strukturat përgjegjëse për realizimin e këtyre proceseve kanë qenë:

**Sekretariati i Këshillit Bashkiak**

**Koordinatori për të drejtën e Informimit dhe Konsultimin Publik**

**Drejtoritë përkatëse sipas fushës së vendimmarrjes.**

Bashkia dhe Këshilli Bashkiak kanë bashkërenduar me qëllim realizimin e një proçesi konsultimi efikas duke optimizuar burimet në dispozicion.

Gjatë vitit 2025 janë realizuar 14 dëgjesa me banorë në qytetin e Hasit dhe njësive administrative përkatëse. Dëgjesat publike, janë realizuar takime të dokumentuara me procesverbal të plotë, pasqyruar në faqen zyrtare në internet të Bashkisë Has, në rrjetet sociale që ka në administrim Bashkia dhe Këshilli Bashkiak dhe në mediat lokale të qytetit.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**BASHKIA HAS**

**KËSHILLI**

Ky Raport Vjetor është hartuar nga Bashkia Has në zbatim të detyrimeve që cakton për autoritetin publik, neni 20 i Ligjit Nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik". Sipas parashikimeve të këtij neni, organet publike hartojnë raporte vjetore për transparencën në procesin e vendimarrjes, ku përfshihet informacion për:

- **numrin e akteve të miratuara nga organi publik përkates gjatë vitit referues;**
- **numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palët e interesuara;**
- **numrin e rekomandimeve të komenteve të pranuara dhe të refuzuara gjatë proçesit.**
- **numrin e takimeve publike të organizuara.**
- **Numri i akteve të miratuara nga organi publik përkatës gjatë vitit 2025.**

Këshilli Bashkiak Has miratoi gjithsej 121 vendime gjatë vitit 2025 të cilat gjenden të publikuara në faqen zyrtare të Bashkisë Has si dhe në platformën e personalizuar VENDIME.AL, në të cilën, publikohen konform standartit të unifikuar të publikimit.

- Rekomandimet e marra gjatë proçesit të konsultimit me palët e interesuara, gjatë konsultimit u rregjistruan në procesverbal, janë gjithsej 35 rekomandime, 2 rekomandime të tjera të marra me postë, e-mail dhe nëpërmjet rrjeteve sociale të këshillit.

- Numri i takimeve publike të organizuara: 14

**1.Bashkia Has në muajin maj 2025, njoftoi hapjen e konsultimeve me publikun "Për planin e masave për ndotjen akustike".**

Për këtë proces konsultimi, Bashkia Has zhvilloi në total 1 takim në kuadër të konsultimit të këtij projekt akti. Në takim morën pjesë 21 individë, nga të cilët 10 femra dhe 11 meshkuj. Nga të gjithë takimet u morën disa propozime të cilat u shqyrtuan nga administrata dhe komisioni i këshillit.

Fokus i diskutimit ishin problematikat për ndotjen akustike si: prania e zhurmave të padëshiruara dhe të dëmshme në mjedis, zakonisht nga burime si trafiku, ndërtimet, aktivitetet industriale apo eventet publike. Në konsultimin publik u diskutuan: **Objektivat e planit të masave, Masat afatshkurtra**: Monitorimi i zhurmës, Kufizimi i zhurmës nga ndërtimet, Ndërhyrje në trafikun rrugor. **Masat afatgjata**: Planifikimi urban i qëndrueshëm, Zhvillimi i transportit publik të qetë, Edukimi dhe sensibilizimi i publikut. **Mbikëqyrja dhe zbatimi**: Bashkia në bashkëpunim me Inspektoratin e Mjedisit do të kontrollojë zbatimin e masave, Vendosja e gjobave për subjektet që tejkalojnë nivelet e lejuara të zhurmës, Raportime vjetore mbi progresin dhe rregullimet e nevojshme në plan. Procesi i konsultimeve u finalizua me miratimin e VKB nr. 49, datë 23. 06. 2025.

**2. Bashkia Has në muajin Qershor 2025, njoftoi hapjen e konsultimeve me publikun "Për rishikimin e buxhetit të Bashkisë Has për vitin 2025 & rishikim i VKB Nr.135 datë 23. 12.2024 Sistemim i Taksave dhe Tarifave Vendore (Taksa Ndërtesës)".**

Për këtë proces konsultimi, Bashkia Has zhvilloi në total 1 takim në kuadër të konsultimit të këtij projekt akti. Në takim morën pjesë 24 individë, nga të cilët 10 femra dhe 14 meshkuj. Nga të gjithë takimet u morën disa propozime të cilat u shqyrtuan nga administrata dhe komisioni i këshillit. Ky takim u drejtua nga Sekretarja e Sekretariatit, me pjesëmarrje të Nënkryetarit, përfaqësues të Drejtorive, Specialistë, kryetar të njësive administrative, Sekretar i Këshillit Bashkiak. Ky konsultim publik kishte për qëllim përfshirjen e komunitetit në vendimmarrje, duke dëgjuar shqetësimet, nevojat dhe sugjerimet e qytetarëve për mënyrën se si duhet të shpërndahen fondet publike gjatë pjesës së mbetur të vitit. U diskutua:

• Ndryshimet e propozuara në buxhetin e vitit 2025.

- Prioritetet e reja të investimeve.
- Fusha të financuara më pak ose më shumë.
- Nevoja të komunitetit që kërkojnë adresim urgjent.

**3. Bashkia Has në muajin Qershor 2025 njoftoi hapjen e konsultimeve me publikun "Për miratimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, Bashkia Has".**

Bashkia Has zhvilloi në total 1 takim në kuadër të konsultimit të këtij projekt akti. Në takim morën pjesë 19 individë, nga të cilët 4 femra dhe 15 meshkuj. Pikat kryesore që u diskutuan në këtë takim ishin: Gjendja aktuale e menaxhimit të mbetjeve në Has, Problematikat kryesore si: deponitë e paautorizuara, mungesa e ndarjes në burim, transporti dhe grumbullimi i pakonsoliduar.

Objektivat për 5 vitet e ardhshme: Edukimi dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve, Infrastruktura për ndarjen e mbetjeve, Partneritete me sektorin privat, Roli i komunitetit dhe bizneseve. Procesi i konsultimeve u finalizua me miratimin e VKB nr. 60, datë 21. 07.2025.

**4. Bashkia Has në muajin Korrik 2025 njoftoi hapjen e konsultimeve me publikun "Për Planin e Integrimit Gjinor, Bashkia Has".**

Bashkia Has zhvilloi në total 1 takim në sallën e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrje të qytetarëve dhe aktorëve kryesorë që trajtojnë Çështjet e Integrimit Gjinor, drejtoritë dhe sektorët përkatës në kuadër të konsultimit të këtij projekt akti. Në takim morën pjesë 16 individë, nga të cilët 9 femra dhe 7 meshkuj. Objektivat strategjikë që u diskutuan në këtë takim ishin: fuqizimi i grave dhe vajzave në të gjitha fushat e jetës publike dhe private, integrimi i perspektivës gjinore në politikat, planet dhe buxhetimin institucional, Ulja e pabarazive gjinore në punësim, arsim, shëndetësi dhe pjesëmarrje politike, Parandalimi dhe adresimi i dhunës me bazë gjinore, Rritja e ndërgjegjësimit publik për barazinë gjinore. Procesi i konsultimeve u finalizua me miratimin e VKB nr. 67, datë 29. 08.2025.

**5. Bashkia Has në muajin Korrik 2025 njoftoi hapjen e konsultimeve me publikun "Për Planin e Arsimit Parauniversitar".**

Bashkia Has zhvilloi në total 1 takim në sallën e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrje të Sekretares së Përgjithshme, Drejtorisë së Arsimit, mësues e përfaqësues të të gjitha shkollave, Inspektorë arsimi, qytetarë etj. Shtyllat kryesore të planit që u diskutuan ishin: përfshirja dhe aksesueshmëria, cilësia e arsimit, gjithëpërfshirja dhe barazia, infrastruktura dhe burimet, qeverisja dhe menaxhimi. Procesi i konsultimeve u finalizua me miratimin e VKB nr. 68, datë 29. 08.2025.

**6. Bashkia Has në muajin Korrik 2025 njoftoi hapjen e konsultimeve me publikun "Për miratimin e Tavaneve Përfundimtare PBA 2026- 2028".**

Bashkia Has zhvilloi në total 1 takim në sallën e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e: Zv. Kryetarëve, Drejtorisë së Pyjeve, Drejtorisë së Financave dhe Tatim- Taksave, Urbanistika, NJA. Fajza, Drejtoresha e kopshtit Krumë, Sekretarja e Përgjithshme etj. Përmes këtij programi synohet përdorimi i përgjegjshëm i taksave dhe rritja e transparencës, duke u mundësuar qytetarëve të përfitojnë nga projektet dhe politikat publike që përmirësojnë jetën e përditshme. Procesi i konsultimeve u finalizua me miratimin e VKB nr. 63, datë 29. 08.2025.

**7. Bashkia Has në muajin Korrik 2025 njoftoi hapjen e konsultimeve me publikun "Për Planin e Veprimit për Diasporën dhe Emigrimin".**

Takimi u zhvillua në sallën e Këshillit Bashkiak ku morën pjesë 16 individë nga të cilët 5 femra dhe 11 meshkuj. Ky takim u drejtua nga specialiste për Migracionin dhe Diasporën me pjesëmarrje të: Sekretares së Përgjithshme, Zv. Kryetares, Sekretarit të Këshillit Bashkiak, përfaqësues nga Bashki të Forta etj. Ky plan përfaqëson një qasje të integruar për bashkëpunimin me diasporën dhe menaxhimin e emigracionit, duke siguruar që qytetarët shqiptarë jashtë vendit të jenë pjesë aktive

e zhvillimit të vendit dhe të kenë mbrojtje të plotë të të drejtave të tyre. Procesi i konsultimeve u finalizua me miratimin e VKB nr. 69, datë 29. 08.2025.

**8. Bashkia Has në muajin Gusht 2025 njoftoi hapjen e konsultimeve me publikun "Për Planin e Integritetit të Bashkisë Has".**

Në këtë takim ku morën pjesë 16 individë nga të cilët 9 femra dhe 7 meshkuj. Ky takim u drejtua nga Specialisti për Koordinimin Evropian dhe Ndihmën e Huaj me pjesëmarrje të: Sekretares së Përgjithshme, Koordinatore për të drejtën e informimit, specialiste për Migracionin dhe Diasporën etj. U diskutua synimi I këtij plani për të krijuar një administrate të përgjegjshme që përmirëson transparencën, promovon llogaridhënien dhe forcon besimin te qytetarët në qeverisjen vendore. Procesi i konsultimeve u finalizua me miratimin e VKB nr. 73, datë 09. 09.2025.

**9. Bashkia Has në muajin Gusht 2025 njoftoi hapjen e konsultimeve me publikun "Plani i Menaxhimit të Pyjeve të Bashkisë Has (i përditësuar)".**

Takimi u realizua në Sallën e Këshillit Bashkiak. Drejtori i Pyjeve bëri të ditur që ky plan është miratuar në vitin 2021 por sillet për konsultim publik për ndryshimet dhe përditësimet here pas here gjatë këtyre viteve. Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve dhanë mendime pozitive për miratimin e këtij plani. Procesi i konsultimeve u finalizua me miratimin e VKB nr. 72, datë 09. 09.2025.

**10. Bashkia Has në muajin Shtator 2025 njoftoi hapjen e konsultimeve me publikun "Për Planin Strategjik i Zhvillimit Vendor 2026-2030".**

Takimi u realizua në Sallën e Këshillit Bashkiak ku morën pjesë 28 individë nga të cilët 12 femra dhe 16 meshkuj. Morën pjesë Zv. Kryetarja, NJA. Fajza, përfaqësues të disa Drejtorive, përgjegjëse dhe specialist të Burimeve Njerëzore, qytetarë etj. Procesi i konsultimeve u finalizua me miratimin e VKB nr. 83, datë 27. 10.2025.

**11. Bashkia Has në muajin Nëntor 2025 njoftoi hapjen e konsultimeve me publikun "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Has 2026, PBA 2026-2028, Taksat dhe Tarifat vendore 2026".**

Takimi u realizua në Pallatin e Kulturës ku morën pjesë 26 individë nga të cilët 11 femra dhe 15 meshkuj. Takimi u drejtua nda Drejtori I Financë me pjesëmarrje të Zv. Kryetarit, Sekretari i Këshillit, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, banorët e Hasit etj. Procesi i konsultimeve u finalizua me miratimin e VKB nr. 109, datë 24.12.2025

**12. Bashkia Has në muajin Nëntor 2025 njoftoi hapjen e konsultimeve me publikun "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Has 2026, PBA 2026-2028, Taksat dhe Tarifat vendore 2026, Njësia Administrative Gjinaj".**

Takimi u realizua në NJA. Gjinaj ku morën pjesë: Kryetari i NJA. Gjinaj, banorët e Gjinaj, Sekretari i Këshillit, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, etj. Procesi i konsultimeve u finalizua me miratimin e VKB nr. 109, datë 24.12.2025. Foto të takimit gjenden të publikuara në këtë link: https://www.facebook.com/photo/?fbid=1152218313792638&set=pcb.1152219957125807

**13. Bashkia Has në muajin Nëntor 2025 njoftoi hapjen e konsultimeve me publikun "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Has 2026, PBA 2026-2028, Taksat dhe Tarifat vendore 2026, Njësia Administrative Fajza".**

Takimi u realizua në NJA. Fajza ku morën pjesë: Kryetari i NJA. Fajza, banorët e Fajza, Sekretari i Këshillit, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, etj. Procesi i konsultimeve u finalizua me miratimin e VKB nr. 109, datë 24.12.2025. Foto të takimit gjenden të publikuara në këtë link: https://www.facebook.com/photo/?fbid=1152218280459308&set=pcb.1152219957125807

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HAS

KËSHILLI

**14. Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Has 2026, PBA 2026-2028, Taksat dhe Tarifat vendore 2026, Njësia Administrative Golaj.**

Takimi u realizua në NJA. Golaj ku morën pjesë 19 individë me pjesëmarrje të: Kryetari i NJA. Golaj, banorët e Golaj, Sekretari i Këshillit, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, etj. Procesi i konsultimeve u finalizua me miratimin e VKB nr. 109, datë 24.12.2025.

Për vitin 2026, Këshilli do të vijojë punën me proceset e konsultimeve publike sipas nevojave për projekt akte duke synuar rritjen e transparencës dhe pjesëmarrjen e banorëve në vendimarrje. Për këtë qëllim ftojmë gjithë aktorët të bëhen pjesë aktive e konsultimit publik dhe të japin mendimet dhe sygjerinet e tyre për të përmirësuar procesin e konsultimit publik.

**Ju faleminderit!**

**SEKRETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**NEZIR LUSHI**

*Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
*Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al*